



Nr. 16/ Prot

48

Datë 31/07/2017



## STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT 2017-2019



1. Një vështrim mbi situatën aktuale	<b>3</b>
2. Misioni dhe Vizioni: Politikat e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm	<b>17</b>
3. Partnerët strategjikë	<b>22</b>
4. Botimet, Revista Shkencore dhe Java e Hapur, si mjete komunikimi dhe llogaridhënieje	<b>34</b>
5. Risqet e komunikimit dhe menaxhimi i tyre	<b>39</b>
6. Objektivat strategjikë dhe Plani i Veprimit	<b>41</b>
<i>Objektivi Nr. 1: Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni</i>	<b>42</b>
<i>Objektivi Nr. 2: Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut</i>	<b>44</b>
<i>Objektivi Nr. 3: Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinionin publik rezultatet dhe dobitë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit</i>	<b>46</b>
<i>Objektivi Nr. 4: Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rrumbullakëta</i>	<b>47</b>
<i>Objektivi Nr. 5: Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive</i>	<b>48</b>
<i>Objektivi Nr. 6: Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit</i>	<b>49</b>
7. Burimet	<b>51</b>
8. Monitorimi i Strategjisë, kontrolli dhe raportimi	<b>52</b>

## 1. Një vështrim mbi situatën aktuale:

*“Si SAI, ne do të njihemi për punën tonë vetëm nëse arrijmë të komunikojmë tek qytetarët në mënyrë të qartë atë se çfarë ne bëjmë dhe po ashtu vlerën e shtuar të gjeneruar nga auditimet tona për Shtetin dhe shoqërinë, në mënyrë që të përceptohemi si institucione strategjike të domosdoshme për interesat e qytetarëve”<sup>1</sup>*

Ndryshimi në drejtimin e institucionit në dhjetor 2011 solli transformime të rëndësishme në filozofinë e menaxhimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit(KLSH), si dhe të raportit të institucionit me palët e interesit në përmbushjen e misionit të tij kushtetues. Kryetari i ri i KLSH-së z. Bujar Leskaj, theksonte në fund-vitin 2011, se *“Do të realizojmë përmirësimin e transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin”<sup>2</sup>*.

Kjo qasje e re e KLSH-së është në përputhje të plotë dhe bazohet në standardet profesionale të auditimit publik suprem, ISSAI-t, dhe përkatësisht në Deklaratën e Limës (ISSAI 1), në Standartin ISSAI 20 *“Parimet e Transparencës dhe të Përgjegjshmërisë”*, Parimi i 8-të, mbi komunikimin në kohë dhe gjerësisht të Institucioneve Supreme të Auditimit(SAI-t), si dhe në ISSAI-n 12 *“Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit – Të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”*, Parimi i 6-të mbi komunikimin efektiv me palët e interesit dhe Parimi i 9-të mbi sigurimin e transparencës dhe të përgjegjshmërisë së duhur nga SAI-et.


Gjatë viteve 2012-2017, institucioni në përmbushje të objektivit për rritjen e transparencës është zhvilluar në disa dimensione. Kështu, krahas rritjes së kanaleve të komunikimit me publikun, përmirësoi përmbajtjen dhe cilësinë e mesazheve në njoftimet e tij për shtyp. Njoftimet për shtyp kanë qenë dhe janë

---

<sup>1</sup> Fragment nga fjala e Dr. Josef Moser, në Simpoziumin e XXI-të OKB-INTOSAI. Dr. Moser, ish-President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe ish-Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t për vitet 2004-2016.

<sup>2</sup> Nga fjala e zotit Bujar Leskaj, kandidat i nominuar nga Presidenti i Republikës për postin e Kryetarit të KLSH-së, me dekretin Nr.7163 date 17.11.2011( i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 23.12.2011), mbajtur në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit më datë 14.12.2011, me rastin e paraqitjes së platformës së tij për drejtimin e KLSH-së.

përcjellësi kryesor i mesazheve publike të institucionit. Ato janë ndërtuar me një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë, të bazuara vetëm në faktet e nxjerra nga auditimet dhe pa konsiderata hipotetike. Institucioni është përpjekur të japë në një format konciz gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga çdo auditim me rëndësi të veçantë për mirë-menaxhimin e parasë publike. Gjetjet nga auditimet, të komunikuara nëpërmjet njoftimeve për shtyp janë kthyer në këto 6 vite në lajm të ditës për televizionet, radiot dhe gazetat kryesore të vendit. Në fund të vitit 2016, institucioni ka qenë i pranishëm 6.7 herë më shumë me informacione dhe mesazhe në median e shkruar dhe ka gjashtëfishuar praninë e tij në mediat audiovizive, krahasuar me vitin 2010. Në 2016, media e shkruar ka pasqyruar raportet e auditimit dhe njoftimet për shtyp të KLSH-së me 931 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike, përkundrajt 922 përgjatë vitit 2015.




### **Prania e KLSH-së në median e shkruar dhe vizive, 2010-2016**

Institucioni ka konsideruar median e shkruar dhe audio-vizive si partnerin kryesor në realizimin e misionit të tij si “watchdog”-u për mirëadministrimin e fondeve dhe pasurisë publike si dhe për të forcuar luftën ndaj korrupsionit. Ky partneritet ka qenë real dhe që në analizën vjetore të KLSH-së të zhvilluar në janar 2012 dhe më tej rregullisht çdo vit, mediat dhe përfaqësuesit më në zë të organizatave jo-qeveritare që luftojnë korrupsionin janë ftuar të marrin pjesë dhe të diskutojnë në analizat në nivel departamenti auditimi dhe në analizën e përgjithshme të KLSH. Transparenca e aktivitetit të institucionit ka përbërë një nga treguesit kryesorë të modernizimit të institucionit dhe ka rritur besimin e publikut dhe qytetarëve ndaj tij.

KLSH-ja e ka konsideruar veten si zërin e qytetarit dhe të publikut. Statistikat tregojnë se nga një numër i papërfillshëm i letrave (ankesa, kërkesa, informacione, etj) të qytetarëve që institucioni merrte dhe trajtonte në vitin 2011, gjatë viteve 2012-2017, letrat dhe kërkesat nga qytetarët janë rritur jo vetëm në numër, por ajo që është më e rëndësishmja dhe që përbën dallimin cilësor konsiston në faktin se në çdo rast qytetarët kanë marrë përgjigje për problemet dhe shqetësimet e ngritura. Vetëm për vitin 2016, KLSH ka trajtuar 660 letra dhe ankesa të qytetarëve, nga të cilat 342 kanë marrë përgjigje. Megjithëse 318 prej tyre kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit, qytetarit i është dhënë përgjigje duke e orientuar se cilit institucion duhet ti drejtohet që ti gjejë zgjidhje shqetësimit të tij.

### Komunikimi me qytetarët në vitet 2002-2016



Duke parë se kanali kryesor i komunikimit me qytetarin, njoftimet për shtyp, ishte i pamjaftueshëm për të dhënë të gjitha mesazhet e punës audituese, lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve, dhe veçanërisht me qasjen këshilluese të KLSH-së që mbështetet në ekspertizën e audituesve me eksperiencë dhe idetë e reja dhe inovacionin e audituesve të rinj, në vitin 2013, institucioni, për herë të parë, në përputhje me Strategjinë e tij të Zhvillimit 2013-2017, Objektiv Nr. 6 “Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit”, një dimension tjetër komunikimit të audituesve me qytetarin dhe opinionin publik, nëpërmjet shkrimeve të audituesve në gazetatat e përditshme të vendit. Ky komunikim u krye në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-ve, dhe pikërisht të ISSAI 1,

Deklarata e Limës, Neni 16 “Raportimi në Parlament dhe ndaj publikut të gjerë”, si dhe të ISSAI 12 “Vlerat dhe dobietë e SAI-ve: të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”, Parimi 4 “Raportimi mbi rezultatet e auditimit, duke mundësuar publikun për të mbajtur qeverinë dhe subjektet e sektorit publik të përgjegjshëm”.

Këto standarde e orientuan institucionin se si të jetë sa më i efektshëm në përcjelljen e informacionit për auditimet dhe gjetjet e tij, jo vetëm për Kuvendin, por edhe për publikun e gjerë dhe qytetarin. Krahas njoftimeve për shtyp për rezultatet e auditimeve, KLSH zgjodhi këtë qasje origjinale dhe të drejtpërdrejtë, komunikimin me qytetarin nëpërmjet shkrimeve, editorialeve, analizave, profileve dhe eseve në shtypin e përditshëm.


Institucioni beson se audituesi, si ai me eksperiencë ashtu dhe audituesi i ri, kanë shumë për t’i ofruar qytetarin dhe opinionit publik, në drejtim të përmirësimit të qeverisjes publike dhe luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit financiar, mbështetur në rezultatet e punës së tyre audituese. Të aftë profesionalisht, audituesit e KLSH-së gjatë viteve 2012-2017, kanë rritur cilësinë e gjetjeve dhe rekomandimeve të tyre, krahas përmirësimit të mënyrës së raportimit të auditimit. Tani është një nevojë dhe kërkesë e përhershme e tyre, që gjetjet dhe rekomandimet e tyre kryesore të mund t’i shtjellojnë me shkrime dhe analiza në shtypin e përditshëm. Nga blogjet mbi temat që kanë zgjedhur për të dalë në publicistikën shqiptare, nga vërejtjet dhe opinionet e lexuesve mbi mënyrën e shtrimit të problemeve dhe zgjidhjet që ata japin, audituesit marrin ide dhe shtypa për shkrime të tjera.

KLSH nuk ka stimuluar botimin e këtyre shkrimeve si qëllim në vetvete, por si mjet për të tërhequr në këtë rrugë edhe punonjësit e institucioneve të tjera publike, duke i shërbyer kështu jo vetëm evidentimit të nëpunësve të përgjegjshëm, por dhe kalimit në një fazë tjetër të luftës ndaj korrupsionit, nëpërmjet transparencës dhe rritjes së komunikimit të institucioneve të tjera shtetërore, duke kontribuar në ndryshimin e perceptimit të publikut si për nëpunësit, edhe për institucionet.



Nga KLSH kjo konceptohet si një sfidë që po realizohet dhe preket ditë pas dite. Institucioni gjykon se shembulli i audituesve të tij, jo vetëm nëpërmjet gjetjeve të tyre dhe rekomandimeve të dhëna gjatë auditimeve, por edhe shkrimeve publicistike, të përcillet tek të gjithë punonjësit e ndershëm dhe të përkushtuar në administratën shtetërore, që edhe ata t’u drejtohen mediave të pavarura, për të shprehur idetë e tyre lirshëm dhe me kurajo, duke kontribuar në luftën kundër korrupsionit dhe transparencën e qeverisjes së vendit.

Duke vijuar një risi pozitive dhe inovative të nisur në vitin 2013, traditë e cila është konsoliduar në këto katër vite, 72 drejtues dhe auditues të KLSH-së kanë qenë të pranishëm në vitin 2016 me 135 shkrime në pothuaj të gjitha gazetatat me qarkullim kombëtar të vendit, duke trajtuar me gjuhë të kuptueshme për lexuesin e thjeshtë temat dhe mesazhet kryesore nga auditimet e kryera. Për katër vite 2013-2016, audituesit e KLSH kanë botuar 396 artikuj, ese, editoriale, analiza e profile në median e shkruar, të cilët janë botuar të përmbledhur në 7 volume (çdo vëllim ka 250 kopje).

### Prania e audituesve të KLSH-së në median e shkruar 2013-2016



Një vlerë e shtuar e KLSH-së në pesë viteve të fundit (2012-2016) në fushën e komunikimit dhe të transparencës së institucionit është kolana e botimeve të saj, e cila ka arritur në fund të vitit 2016 në 67 tituj, nga vetëm 12 botime modeste të periudhës 1992-2011. Çdo vit dinamika e botimeve të institucionit rritet me 10 përqind, duke synuar që për periudhën janar 2012-dhjetor 2018 të arrijë në 100 libra të botuar. Kolana e botimeve pasqyron çdo kronikë të reformave që ka nisur KLSH, modernizimin e institucionit, hapjen e tij të plotë në publik, duke ndihmuar edhe në njohjen më të gjerë të natyrës së tij dhe shtimin e besimit të qytetarëve ndaj punës audituese.



Titujt e kolanës së botimeve të KLSH-së janë vërtet impresionues, si për larmishmërinë e temave, ashtu dhe për sasinë e informacionit që përmbajnë si për lexuesit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, ashtu edhe për lexuesin e thjeshtë të interesuar për fushën e auditimit.



Botimet e KLSH-së janë zbatim i detyrimeve ndërkombëtare të angazhimit të institucioneve të auditimit edhe në fushën e botimeve të dokumentacionit, për t'i mundësuar qytetarëve një akses më të gjerë.

Një tjetër dimension i rëndësishëm është komunikimi me Parlamentin. Qysh prej vitit 2012, KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë marrëdhënieve me Parlamentin duke e konturuar këtë raport në shinat e forcimit të llogaridhënies, transparencës dhe mirëqeverisjes. Vullneti për thellimin e bashkëpunimit ka qenë reciprok sepse edhe Kuvendi ka treguar një vëmendje të veçantë në raport me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Kontributi i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, kryetarit të saj dhe Kryetarit të Kuvendit ka qenë thelbësor për miratimin e ligjit të ri të KLSH-së 154/2014 (datë 27/11/2014), një ligj që inkorporoi standardet e INTOSAI-t në auditimin e jashtëm në Shqipëri dhe që përforcoi pavarësinë e institucionit. KLSH dhe veçanërisht Kryetari i saj kanë bërë përpjekje të mëdha përgjatë një viti të plotë për të bërë të mundur që ligji i ri i KLSH të miratohet nga Kuvendi në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të Auditimit.

Në rrafshin e komunikimit institucional dhe të detyrimeve të ndërsjella kushtetuese midis dy institucioneve, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka dërguar Kuvendit disa raporte me ndjeshmëri të lartë publike, ndër të cilat përmendim:

- Informacion mbi rekomandimet e KLSH-së për auditimin e Bankës së Shqipërisë;
- Raportin e Auditimit të Performancës mbi Rehabilitimin e ish-të Përndjekurve Politikë;
- Raportin e Auditimit të Performancës mbi Transportin Publik në Bashkinë Tiranë;
- Rekomandimet e KLSH-së mbi auditimin e kryer në Ministrinë e Punëve të Brendshme (ndarja administrative territoriale);
- Informacion mbi auditimin e kryer në Drejtorinë e Përgjithshme Portuale të Durrësit;
- Raportin e Auditimit “Mbi Zbatimin e Ligjshmërisë dhe Rregullshmërisë së Veprimtarisë Ekonomike-Financiare” në OSHE, OST, KESH;
- Raportin e Auditimit të Performancës me temë “Mbrojtja e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet” në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë;
- Raportin përfundimtar si dhe rekomandimet e KLSH-së mbi auditimin e AKBN;

- Informacione, raporte, rekomandime të KLSH-së mbi auditimin në Albpetrol sh.a.;
- Raportin e Auditimit të Performancës në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare;
- Informacion mbi integritetin e zyrtarëve të administratës shtetërore;
- Kërkesa të njëpasnjëshme për auditimin e llogarive financiare të KLSH-së, etj.
- Një trajtim të veçantë nga Kuvendi ka marrë raporti i auditimit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) dhe Avokaturën e Shtetit, e njohur në media si çështja CEZ. Komisioni i Posaçëm Parlamentar, i ngritur për të hetuar zbatimin e legjislacionit shqiptar në mbrojtje të interesave të vendit gjatë marrëveshjes për zgjidhje me mirëkuptim mes CEZ dhe Republikës së Shqipërisë, ka pritur në tetor të 2016 në seancë dëgjimore kreun e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Viti 2016 njohu një moment tepër të rëndësishëm për zhvillimin e marrëdhënieve KLSH-Parlament sipas standardeve më të mira europiane. Kuvendi miratoi Rezolutën për Vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015. Kjo rezolutë shpreh angazhimin maksimal të Kuvendit me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit si dhe mundësinë e krijimit të Nënkomisionit parlamentar brenda Komisionit për Ekonominë dhe Financat për të monitoruar në mënyrë sistematike aktivitetin e KLSH-së dhe veçanërisht zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga institucionet e shtetit.

Ekzistenca e një komisioni të “profilizuar” për auditimet e KLSH-së do të mundësojë një komunikim të vazhdueshëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit me Kuvendin, duke i mundësuar qytetarit një njohje më të mirë mbi mënyrën se si shpenzohen fondet publike. Në këtë prizëm, rekomandimet e KLSH-së do të shërbejnë jo vetëm për efekt rregullues e zhdëmtues, por edhe si “input” që Parlamenti mund t’i përdor në hartimin e politikave buxhetore.

Për të gjitha detyrat e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, Kontrolli i Lartë të Shtetit ka hartuar plane konkrete pune për zbatimin e tyre. Kontrolli i Lartë i Shtetit, si Institucioni më i lartë i kontrollit Ekonomiko- Financiar në vend, njëherazi është agjent i Kuvendit për të siguruar mirë-administrimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, në bazë të Standardeve të INTOSAI-t. KLSH e zbaton këtë mision dhe detyrë madhore, duke i raportuar Kuvendit sipas përcaktimeve kushtetuese, si dhe duke zbatuar çdo rekomandim dhe orientim të Kuvendit. Janë këto arsye që institucioni i ka konsideruar në pesë vitet e fundit Rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë “Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si programe të qarta pune për të.

Këto rekomandime janë përfshirë natyrshëm në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH.

Një përmasë tjetër e promovimit dhe forcimit të komunikimit në KLSH, që ka theksuar dhe garantuar profilin e fituar profesional të institucionit, është organizimi për herë të parë i konferencave shkencore, për nxitjen e mendimit të përparuar shkencor për çështje të sotme të auditimit publik dhe të financave publike, duke përfshirë kontributet e institucioneve partnere të KLSH në rajon dhe më gjerë në Evropë, përfaqësuesve më aktivë e cilësorë të akademikëve dhe profesorit shqiptar, si dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, pa anashkaluar në asnjë rast kontributin e audituesve të institucionit. Konferenca Shkencore është afirmuar si një forum i rëndësishëm për të vendosur një komunikim të drejtpërdrejtë, përmes prezencës së theksuar të mediave, për të transmetuar tek qytetarët arritjet, sfidat, problematikat dhe idetë e reja për menaxhimin e shëndoshë të financave publike. Një tjetër tipar i rëndësishëm i Konferencës Shkencore është se mbledh në një tryezë diskutimi të gjithë palët e interesit, përfshirë anëtarë të qeverisë, duke realizuar kështu një komunikim të drejtpërdrejtë dhe konstruktiv në funksion të promovimit të mirëqeverisjes. Konferenca e I-rë u zhvillua në vitin 2012 dhe ka trajtuar temën “87 vjet KLSH në 100 vjet shtet shqiptar”, Konferenca e II-të me temë “*Roli i SAI-t për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme*” u zhvillua në dhjetor të vitit 2013 dhe Konferenca e III-të, tetor 2014 trajtoi si temë kryesore “*Auditimi Kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare*”. Me rëndësi për t’u përmendur është Konferenca e IV-t Shkencore “*Analiza e Riskut*”, e cila u zhvillua në qershor të vitit 2016 dhe bëri publike hartën e risqeve në sektorin publik shqiptar, me qëllim informimin e qytetarëve për zonat nevralgjike të shërbimeve publike dhe nxitjen e ndërgjegjësimit qeveritar për marrjen e masave për reduktimin e risqeve.



*Zoti Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së gjatë fjalës së tij në Konferencën e I-rë Shkencore të KLSH-së “87 vjet KLSH në 100 vjet shtet shqiptar” (dhjetor 2012)*



*Konferenca e II-të Shkencore e KLSH-së “Roli i SAI-t për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme” (dhjetor 2013)*



*Konferenca e III-të Shkencore e KLSH-së “Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare” (tetor 2014)*



*Konferenca e IV-të Shkencore e KLSH-së “Analiza e Riskut” (qershor 2016)*

Në vitin 2017, KLSH në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës dhe me Fondacionin Turk, “*Bashkëpunimi akademik për Kontabilitetin*” do të organizojë në Tiranë, në datat 11-13 tetor Konferencën e V-të Shkencore me temë “*Auditimi, Qëndrueshmëri dhe Zhvillim*”.

Edhe pse arritjet në hapjen e plotë të institucionit dhe shndërrimin e tij në një institucion të hapur dhe transparent për publikun dhe qytetarin, që realizon një komunikim efektiv me palët e interesit, janë të dukshme, KLSH vëren dhe thekson nevojën për një strategji të re të komunikimit me palët e interesit, sidomos me publikun dhe qytetarin, duke parë zhvillimet e vullshme të mediave sociale dhe të teknologjisë së informacionit, si dhe në dritën e orientimeve të fundit strategjike të Kongresit INCOSAI XXII, zhvilluar në Abu

d'Habi të Emirateve të Bashkuara Arabe në dhjetor 2016, motoja e të cilit ishte “SAI-t në shërbim të qytetarit” dhe një ndër mesazhet qendrore “SAI-t dhe INTOSAI të shndërrohen në një zë publik në shërbim të interesave të qytetarit”.

Në këtë drejtim KLSH ka bashkëpunuar me grupet e interesit dhe me organizatat e shoqërisë civile, duke komunikuar dhe diskutuar rezultatet e disa auditimeve të rëndësishme :

- Departamenti i Auditimit të Performancës ka bërë publike rezultatet e auditimit me temë “*Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë në Periudhën e Tranzicionit*”, ku morën pjesë përfaqësues të të gjithë Shoqatave të ish të Përndjekurve Politikë të vendit tonë, drejtues të Institutit të Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë dhe të Institutit të Studimit të Krimeve të Komunizmit, ish të burgosur politikë, disa OJF, përfaqësues të medias, studiues, etj.
- Organizimi i një workshopi në bashkëpunim me “*Albanian Platform for Policy Advocacy (APPA)*” ku u trajtua tema “*Prezantimi i gjetjeve nga monitorimi i qeverisë për vitin 2015 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2016*”. Përfaqësues të KLSH bënë një bilanc të të gjitha auditimeve të kryera si dhe numrin e kallëzimeve të dërguara në prokurori. Fusha ku ka pasur më shumë abuzime është ajo e prokurimit publik, ndërkohë një tjetër sektor i gjetur me shkelje kanë qenë Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në raportin përfundimtar të Auditimit në Autoritetin Portual Durrës, KLSH është bazuar edhe tek informacionet dhe gjetjet e Organizatës “*Albanian Platform For Policy Advocacy*” në lidhje me disa procese të projektit TAP.
- Takim i Kryetarit të KLSH-së me drejtues dhe sindikalistë të Unionit të Punonjësve të Shqipërisë(UPSH) lidhur me pushimin nga puna të 410 naftëtarëve nga Kompania “Albpetrol”. Sindikalistët theksuan se i janë drejtuar KLSH-së për zgjidhje sepse vlerësojnë punën profesioniste të audituesve të këtij institucioni, më së shumti auditimet e realizuara në vitet e fundit në AKBN dhe në Albpetrol, rekomandimet e të cilave janë shumë profesionale, të drejta dhe të bazuara në ligj. Rekomandimet e këtyre auditimeve do të vlerësohen nga UPSH dhe sindikalistët për ta zgjidhur problemin në favor të punonjësve të industrisë së naftës.

KLSH ka bashkëpunuar dhe ka realizuar leksione me personalitete të shquara kombëtare dhe ndërkombëtare të fushave të ndryshme, duke transmetuar tek audituesit e KLSH-së njohuritë e fushës së auditimit dhe më gjerë. Këtu mund të përmendim leksionet e realizuara me Ass.Prof.Dr.Recai Akyel, ish-president i Gjykatës Turke të Llogarive, Dr.Igor Soltes, ish-President i SAI-t Slloven dhe aktualisht deputet i Parlamentit Europian, z.Jacek Jezerski, ish President i SAI-t Polak, z. Wojciech Kutyla, zv/President i SAI-t Polak, etj.

Për t'u evidentuar është leksioni i profesorit të shquar amerikan, Sang M. Lee, University Eminent Scholar dhe Regents Distinguished University Professor Emeritus, i Universitetit të Nebraskës-Lincoln, me temë *“Inovacioni, si mjet për krijimin e një shoqërie efiçiente në Epokën Dixhitiale”*, mbajtur në nëntor të vitit 2016 në sallën e Akademisë së Shkencave.



*Profesor Sang M. Lee dhe z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së gjatë leksionit “Inovacioni, si mjet për krijimin e një shoqërie efiçiente në Epokën Dixhitiale”*

Gjithashtu në sallën e Akademisë së Shkencave, në mars të vitit 2017, znj. Janet St.Laurent, Drejtoreshë e Qendrës së Ekselencës në Auditim të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA-së (GAO), zhvilloi një leksion të hapur me audituesit e KLSH-së, me temë *“Roli i GAO-s në provimin e llogaridhënies, rezultateve dhe bashkëpunimit”*.



*Znj. Janet St.Laurent, Drejtoreshë e Qendrës së Ekselencës në Auditim të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA-së (GAO) dhe z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së*

Në ambientet e Universitetit Politeknik është organizuar një takim i Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit me Profesor Ismet Elezin. Profesor Elezi në ligjëratën e tij u ndal kryesisht në temën “*Kultura Juridike në KLSH*”, duke theksuar që Kultura Juridike është normë, është mbi gjithçka, thënë ndryshe ...” *kultura juridike është tërësia e njohurive dhe ideve për të kuptuar se çfarë është sundimi i ligjit...*”. Kultura juridike duhet patjetër të plotësohet me integritetin moral dhe ndërgjegjen, në çdo rast që flasim për zbatimin e ligjeve.



*Gjatë takimit të Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit me Profesor Ismet Elezin. (Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së; Prof. Dr. Ismet Elezi; Prof. Dr. Aurela Anastasi)*

Me shumë interes është ndjekur nga audituesit e KLSH-së leksioni i z. Përparim Kabo, filozof, antropolog, kritik arti, etj. Zoti Kabo promovoi librin e

tij më të ri titulluar *EPISTOLATE-Antropologjia e frymës* dhe shkurtimisht bëri një pasqyrë të botimeve të tij në vite.

Gjatë analizës vjetore të KLSH-së për vitin 2016, në përfundim të punimeve të saj audituesit e KLSH-së patën rastin të ndjekin një leksion të sociologut Gëzim Tushe.

Të gjitha këto leksione kultivojnë frymën e bashkëpunimit dhe të përfitimit nga eksperiencia dhe njohuritë e personaliteteve publike (jo vetëm të fushës së auditimit), duke ndikuar në forcimin e personalitetit dhe të kulturës së audituesve të KLSH-së.

Që të shndërrosh në një zë publik, duhet të kesh një strategji të qartë për komunikimin dhe marrëdhëniet me qytetarin. KLSH vlerëson rëndësinë e komunikimit, pra marrjen, përpunimin dhe dhënien e informacionit, si një fushë strategjike për çdo institucion, përfshirë institucionin suprem të auditimit (SAI-n). Sigurimi i komunikimit të efektshëm me qytetarin dhe publikun është një prej sfidave më të mëdha dhe më emergjente, me të cilat përballen sot SAI-t.

KLSH aspiron të zbatojë një politikë komunikimi sa më të efektshme, pasi ajo luan një rol kyç në funksionimin e institucionit dhe përmbushjen e misionit të tij. Cilësia e politikës së institucionit përcakton mënyrën e perceptimit të KLSH-së nga palët e interesit. Kjo është veçanërisht thelbësore kur bëhet fjalë për transparencën dhe besimin e publikut.

Efektshmëria e politikës së komunikimit është gjithashtu me rëndësi parësore për KLSH-në për shkak të qëllimit të projektuar, që është maksimizimi i vlefshmërisë së raporteve të auditimit dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit.

Strategjia e Komunikimit 2017-2019 synon rritjen e të kuptuarit të parimeve dhe funksioneve të KLSH nga publiku dhe qytetari, nga institucionet, organizatat joqeveritare dhe media. Ajo do të provojë të stimulojë debat publik rreth gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH, debat i cili çon më pas në rritjen e sensibiliteteve të grupeve të ndryshme shoqërore, ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të institucionit përgjatë auditimeve të tij. Realizimi i komunikimit të KLSH me grupe të ndryshme shoqërore, duke vendosur në qendër qytetarin, do të sjellë rritjen e kontrollit qytetar dhe shoqëror në përdorimin e Buxhetit të Shtetit.



## **2. Misioni dhe Vizioni: Politikat e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm**

### **2.1 Misioni:**

*Informimi i qytetarit, publikut dhe Kuvendit në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efizienzë nga pushteti qendror dhe vendor dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikatat më të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit.*

### **2.2 Vizioni:**

*KLSH synon të jetë një trupë profesionale që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë e të enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe të audituarit.*

### **2.3 Politikat e komunikimit**

- Identifikimi i palëve kyçe të interesit me të cilët KLSH duhet të komunikojë për të arritur objektivat institucionale;
- Identifikimi i mesazheve kyçe që SAI synon të komunikojë;
- Identifikimin e mjeteve dhe qasjeve të duhura për komunikimin e jashtëm;
- Koordinimin e strategjisë së komunikimit me planin strategjik;
- Përcjellja në kohë, me saktësi dhe në mënyrë të plotë e informacioneve mbi aktivitetet e KLSH-së;

- Garantimi i transparencës dhe aksesibilitetit të të gjitha palëve të interesit në KLSH;
- Promovimi i parimeve bazë të transparencës në komunikim, duke garantuar objektivitet dhe kuptueshmëri për informacionet që përcillen;
- Sigurimi se të gjitha mjetet e komunikimit janë në përputhje me Misionin, Vizionin, ligjin organik të KLSH-së dhe Objektivat Strategjikë;
- Promovimi i një komunikimi efektiv me qytetarët dhe Parlamentin, në kuadër të rolit të KLSH-së si një “watchdog” që siguron transparencë mbi fondet publike;
- Promovimi dhe përdorimi i mjeteve të reja të komunikimit, për të siguruar një informacion të shpejtë, të besueshëm dhe gjerësisht të aksesueshëm.

## **2.4 Komunikimi i jashtëm**

- Strategjia për komunikimin e jashtëm është koherente, gjithëpërfshirëse, bashkëkohore dhe përfshin të gjithë personelin e KLSH-së.
- Komunikimi është i saktë, i qartë, koherent dhe i paanshëm. KLSH-ja përdor të njëjtën gjuhë dhe e përshtat formën e të shprehurit në varësi të rolit të institucioneve në shërbim të publikut.
- KLSH-ja i kushton vëmendje të veçantë përgatitjes së informacionit, në mënyrë që ai të jetë i plotë dhe të përmbajë të gjitha të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të auditimit, në mënyrë që marrësit e këtij informacioni të formulojnë mendimin e tyre të pavarur. Mesazhet përcillen në formën e përshtatshme dhe në kohë.
- Drejtoria e komunikimit në KLSH përdor të gjitha kanalet e disponueshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të komunikimit me qëllim që të përcjellë informacion rreth rezultateve të auditimit tek një

numër sa më i madh marrësish. Është thelbësore që KLSH-ja të ndjekë zhvillimin natyral të shërbimeve të internetit dhe komunikimit nëpërmjet mediave sociale.

- Në të njëjtën kohë, KLSH-ja i trajton mediat sociale si mjete jo vetëm për promovimin e punës së institucionit, por edhe si element i projektit social që çon drejt zhvillimit të shoqërisë civile, rrit besimin tek institucioni dhe mbështet efektshmërinë e administratës publike.
- Për më tepër, KLSH-ja kujdeset që politika e komunikimit, e cila zbatohet me anë të përdorimit të mjeteve bashkëkohore të komunikimit, siç janë ato elektronike, të mos e bëjnë komunikimin më pak individual. Objektiviteti dhe ligjshmëria që ofron KLSH-ja nuk përjashtojnë mundësitë e kontaktit personal. Për KLSH-në, marrëdhëniet, diskutimet dhe kontaktet e drejtpërdrejta krijojnë mundësi për të shpjeguar dyshimet që mund të lindin, për të përmirësuar imazhin dhe rritur besimin në institucion.
  - Politika e komunikimit përfshin të gjithë personelin e KLSH-së, meqenëse janë ata të gjithë që krijojnë institucionin dhe punojnë për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.
  - Të gjithë punonjësit e KLSH-së marrin pjesë në zbatimin e kësaj strategjie, përkatësisht sipas detyrave dhe pozicioneve të tyre. Një nga vlerat e tjera të strategjisë së komunikimit është ndërgjegjësimi i punonjësve të KLSH-së që ata të gjithë janë “ambasadorë” të institucionit.

## **2.5 Komunikimi i brendshëm**

- KLSH-ja e njih rëndësinë e komunikimit të brendshëm dhe për rrjedhojë, e zbaton atë. Duke qenë e ndërgjegjshme për lidhjen e drejtpërdrejtë të efektshmërisë dhe përmirësimit të politikës së komunikimit të jashtëm dhe imazhit të institucionit në syrin e publikut, KLSH-ja prezanton tek punonjësit e saj idenë e “ambasadorëve” të institucionit.

- Në të ardhmen e afërt, Intraneti do të jetë mjete kryesor për mbështetjen e komunikimit të brendshëm efektiv dhe do të përbëjë platformën qendrore në të cilën mblidhen informacione dhe shkëmbehet informacion dhe eksperiencat pozitive të punës audituese. Intraneti do të jetë i aksesueshëm për të gjithë punonjësit, pavarësisht vendit të tyre të punës. Informacioni duhet të paraqitet sipas një strukture të qartë dhe koherente që përfshin edhe opsionet e kërkimit. Me qëllim që të mundësohet ndarja e informacionit të intranetit, por edhe të ofrohet mundësia e krijimit të lidhjeve ndërmjet elementeve të veçanta, duhet të sigurohet mundësia e krijimit të lidhjeve individuale me elementë të veçantë.

## 2.6 Përdoruesit e informacionit

- Të gjithë përdoruesit e komunikimit, raporteve dhe botimeve të KLSH-së trajtohen në mënyrë të barabartë, me respektin e duhur, me mirëkuptim ndaj nevojave dhe pritshmërive të tyre.
- KLSH-ja ndërmerr të gjitha aktivitetet në përputhje me karakterin e institucionit, me qëllim komunikimin me numrin më të lartë të përdoruesve dhe grupeve të tyre. KLSH-ja maksimizon përpjekjet që qytetarët dhe përdoruesit e raporteve të auditimit dhe informacionit rreth saj të marrin më të mirën e mundshme dhe në kohë sa më të shpejtë, duke rritur besimin e qytetarit tek puna dhe veprimtaria e KLSH-së.
- Në përmbushje të misionit të saj si institucion publik, KLSH-ja është e detyruar të japë kontributin e saj edhe në drejtim të shoqërisë civile. Sipas kapacitetit dhe mundësive të saj organizativ, KLSH-ja organizon aktivitete të ndryshme me këtë qëllim.
- KLSH-ja bashkëpunon me institucione shkencore, p.sh.: universitete dhe organizon konferenca të përbashkëta dhe aktivitete të tjera për promovimin e punës së KLSH-së, misionit, veprimtarisë, organizimit dhe detyrave të saj.

- KLSH-ja ka për qëllim ta bëjë komunikimin me qytetarët dhe palë të tjera interesi sa më personal dhe sa më të thjeshtë që të jetë e mundur. Për ta realizuar këtë, KLSH-ja përdor mekanizma për marrjen e ankesave nëpërmjet të gjithë kanaleve të disponueshëm të komunikimit, p.sh.: me anë të postës elektronike, letrave të zakonshme, takimeve në KLSH, etj. Në këtë mënyrë, KLSH-ja përmbush pritshmëritë e qytetarëve në këtë drejtim.

### 3. Partnerët strategjikë

Kjo strategji dhe mision komunikimi i KLSH-së nuk mund të realizohen pa ndërtuar një partneritet funksional me të gjithë palët e interesuara. Ky partneritet është shpallur si prioritet strategjik i punës së institucionit.

KLSH konsideron si partnerë strategjikë kryesorë në realizimin e misionit të tij të komunikimit :

- Taksapaguesit (qytetarët shqiptarë);
- Kuvendin e Shqipërisë;
- Institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe mediat;
- SAI-t (Institucionet supreme të auditimit) homologe, anëtare të EUROSAT dhe INTOSAT-t; Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO) dhe Gjykata Europiane e Audituesve (ECA);
- Delegacionin e BE-së dhe programin SIGMA;
- Shoqatat profesionale të fushës.

KLSH është i ndërgjegjshëm se nuk mund t'i arrijë objektivat e përcaktuara në këtë Strategji pa ndihmën e qenësishme të partnerëve të tij kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

#### 3.1. Taksapaguesit

*“Ne, SAI-t përballemi me sfidat e shekullit XXI, duke përdorur teknikat e shekullit të XX-të në institucionet e shekullit të XIX-të”*<sup>3</sup>. Ky përkufizim i z. Arno Visser, President i EUROSAT-t, reflekton rëndësinë e transparencës dhe komunikimit me qytetarët, veçanërisht për një Institucion Suprem Auditimi që operon në kohën moderne të Teknologjisë së Informacionit. IT-ja ka parakaluar sot politikën, në kuptimin e nxitjes së transparencës, e ka ofruar qytetarin me institucionet publike përmes vetëm një klik. KLSH ndjek parimin e *“Partneritetit me Qytetarin dhe Qeverisjes së Hapur”*. Për realizimin e misionit të tij, KLSH po zhvillon këtë strategji komunikimi, e cila ka për

---

<sup>3</sup> “Ne, qytetarët”, artikull i Presidentit të Gjykatës Hollandeze të Auditimit, z. Arno Visser, President i EUROSAT-t, botuar në Revistën e INTOSAT-t (Pranverë 2016).

qëllim t'u drejtohet qytetarëve dhe taksapaguesve drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe mediave, duke u siguruar mundësinë dhe aksesin e plotë qytetarëve për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët që është mirëqeverisja. Produktet e kësaj strategjie janë botime të ndryshme si libra, buletine statistikore, broshura informative, faqja e internetit, konferenca dhe njoftime për shtyp, fletë-palosje, prani dhe aktivitet intensiv i KLSH në panairë të librit, rrjetet sociale, portale të dedikuara, etj., të cilët janë në funksion të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve.



*Stenda e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Panairin e përvitshëm të Librit në Pallatin e Kongreseve*

Pritshmëritë dhe kërkesat e qytetarëve dhe taksapaguesve për mirëqeverisje dhe luftë efektive ndaj korrupsionit kërkojnë një SAI modern, transparent dhe të përgjegjshëm. Por, çka synojmë përmes transparencës si agjent i Kuvendit dhe qytetarëve, një “watchdog” është jo vetëm të përcjellim informacione mbi aktivitetin e institucionit dhe të raportojmë për auditime, por të nxisim pjesëmarrjen e tyre në vetë qeverisjen publike.

### **3.2 Kuvendi i Shqipërisë**

Marrëdhënia KLSH - Kuvend është e natyrshme dhe nuk duhet kuptuar si diçka artificiale e protokollare. Kontrolli i Lartë i Shtetit është agjent i

Parlamentit dhe i qytetarëve, për të siguruar administrimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike, në bazë të Standarteve të INTOSAI-t.

Nga viti në vit, KLSH dhe Kuvendi i kanë ngritur raportet e tyre në një shkallë më të lartë duke shërbyer si aktorë kryesorë të transparencës dhe llogaridhënies, në funksion të informimit të qytetarëve mbi mënyrën sesi shpenzohen fondet publike. Pjesëmarrja e Kryetarit të Kuvendit, deputetëve dhe Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat në aktivitetet e KLSH-së si Analizat Vjetore, konferencat shkencore etj., dëshmojnë për mbështetjen parlamentare që gëzon Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raportet e auditimit të KLSH-së po citohen gjithnjë e më shumë në komisionet parlamentare dhe ky është një indikator i besimit në rritje të Kuvendit ndaj KLSH-së. Ky besim i Kuvendit është një inkurajim i madh për punën audituese të Kontrollit të Lartë të Shtetit sepse mundëson funksionimin e mekanizmave të “Trekëndëshit të Llogaridhënies” (SAI-Parlament-Ekzekutiv), pasi i projekton gjetjet dhe rekomandimet e auditimit pikërisht drejt identifikimit dhe zgjidhjes së problematikave të qeverisjes publike, duke përforcuar kështu mirëqeverisjen.

Raportet kryesore drejtuar Kuvendit, ai i realizimit të Buxhetit Faktik të Shtetit për vitin paraardhës dhe raporti i performancës së KLSH, në rolin e institucionit si agjent i Kuvendit për mirëmenaxhimin e parasë publike, njohën thellësinë e argumentit dhe gjetjes audituese, dobinë e plotë të rekomandimeve në përmirësim konkret të menaxhimit të fondeve publike, sipas orientimeve të standardeve ISSAI, duke siguruar drejtpërdrejtshmëri dhe lexueshmëri nga anëtarët e Kuvendit.

Ndërkohë, ndryshimet në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucionit kishin nevojë për një kuadër të ri ligjor, i kërkuar dhe nga Progres-Raportet e Bashkimit European të viteve 2008-2013. Ky kuadër u plotësua me miratimin nga Kuvendi në nëntor 2014 të ligjit të ri të KLSH, i cili u përshëndet nga Delegacioni i BE në Tiranë si një akt në dobi të procesit të integritetit të vendit. Ligji është tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe i hapi rrugën mbështetjes së BE-së për reformën e menaxhimit të financave publike në Shqipëri.



Në vitin 2016, bashkëpunimi KLSH-Parlament ka fituar edhe një njohje ndërkombëtare. Në datën 8-9 nëntor në Ankara të Turqisë u zhvillua Konferenca e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate, vendeve potencialisht kandidate të BE-së dhe Gjykatës Europiane të Audituesve (ECA) me temë *“Zhvillimi i marrëdhënieve efektive ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve”*, organizuar nga Programi SIGMA, një iniciativë e BE-së dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, në bashkëpunim me Gjykatën e Llogarive të Turqisë. Në konferencë morën pjesë SAI-et e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Turqisë, Bosnjë-Hercegovinës, Serbisë, Malit të Zi, si dhe përfaqësues të Gjykatës Europiane të Audituesve, Komisionit European dhe SIGMA-s. KLSH u përfaqësua nga Kryetari ndërsa Parlamenti nga një deputet, anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Konferenca theksoi se puna e një SAI është punë integrale e vetë Parlamentit, e parë kjo në këndvështrimin e formulës se “SAI është agjent i Parlamentit”. Si e tillë, ndjekja e rekomandimeve shtron detyra edhe për vetë Parlamentin. Për këtë arsye projektimi i rekomandimeve nga vetë Parlamenti e adreson punën audituese drejt transparencës dhe llogaridhënies, duke përmirësuar kështu menaxhimin e fondeve publike. Prezenca e deputetëve në këtë konferencë, së bashku me delegacionin e KLSH-së, është një dëshmi e marrëdhënieve pozitive që ekzistojnë mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë.

### **3.3. Institucionet shtetërore, shoqëria civile dhe mediat**

Gjatë periudhës 2012-2017 janë nënshkruar 25 marrëveshje bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile, organizata të profesionistëve të fushës, Universitete, etj:

#### Viti 2012

- Lëvizja Europiane Shqipëri
- Instituti i Studimeve Bashkëkohore
- Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë
- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

- Transparency International Shqipëri
- Alternativa Civile
- Instituti “G&G” Group
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
- Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

#### Viti 2013

- Fakulteti Gjeologji-Miniera
- Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Audituesve të Kosovës
- Instituti për Studime Publike dhe Ligjore
- Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
- Gazeta “Ekonomia”

#### Viti 2014

- Instituti Shqiptar i Shkencës
- Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë

#### Viti 2015

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- Qendra shqiptare për rehabilitimin e traumës dhe torturës
- Organizata “Integrimi Urban”

#### Viti 2016

- Revista “MONITOR”
- KONFINDUSTRIA
- Albanian Platform for Policy Advocacy
- Fakulteti Ekonomik
- Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (Kosovë)


## Viti 2017

- Universiteti “Luarasi”

KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 8 institucione shtetërore: ILDKPKI, Ministria e Financave, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, DAP, APP, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.



*Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes KLSH-së, përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Pranvera Strakosha*



*Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes KLSH-së, përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Parandalimit të Pastrimit të Parave, z. Arlind Gjokuta*

Në tërësi, përmes këtij bashkëpunimi, Kontrolli i Lartë i Shtetit është i lidhur me të gjitha hallkat e tjera shtetërore dhe me pothuajse të gjitha OJQ-të që operojnë në Shqipëri. Ky partneritet buron nga nevoja e ndërsjellë që kanë palët për informacion. KLSH merr nga shoqëria civile dhe mediat informacione të vlefshme, të cilat mund t'i bëjë subjekte të auditimit, ndërkohë që mediat, në respekt të detyrimit dhe profesionit për të informuar qytetarët, marrin nga KLSH informacione mbi rezultatet e auditimit. Ky proces i ndërsjellë i shërben edhe rritjes së besimit të publikut në institucionin e KLSH si dhe monitorimit të tij nga publiku, ashtu si edhe rritjes së besimit të publikut ndaj qeverisjes.

Partneriteti me shoqërinë civile dhe mediat ka filluar të institucionalizohet në vitin 2012 nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara nga Kryetari i KLSH me disa OJF, ndër më aktivet në luftën kundër korrupsionit dhe për më shumë transparencë në qeverisje<sup>4</sup>. Ky partneritet është zgjeruar dhe shpalosur fort përgjatë viteve 2013-2017, duke kulmuar në aktivitete të përbashkëta, mini peer review për institucionin, me pjesëmarrjen e ekspertëve nga shoqëria civile, si dhe në pjesëmarrjen e shumë ekspertëve të organizatave joqeveritare në auditime të KLSH-së. Ai do të vijojë të jetë pjesë e zhvillimeve strategjike të institucionit për vitet 2017-2019, duke sjellë një rol të shtuar të shoqërisë civile në rritjen e transparencës dhe komunikimit të KLSH, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e punës së tij.

### **3.4. SAI-t homologe, Organizatat Ndërkombëtare të Auditimit, GAO, ECA dhe Shoqatat profesioniste të fushës**

KLSH është anëtar i INTOSAI-t që nga viti 1984 dhe anëtarësimi në këtë organizatë shtrihet detyrë për të respektuar standardet e saj, duke i zhvilluar ato në përputhje me kushtet e vendit tonë. KLSH është gjithashtu anëtar i EUROSAI-t, organizatës europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit. Vitet 2012-2017 njohën pjesëmarrje të gjerë të institucionit në Kongreset, konferencat, seminarët dhe takimet e punës të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t. Përveç kësaj, KLSH, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe me SAI-t partnere në Europë, ka realizuar trajnime intensive të stafit të saj, duke rritur kapacitetet audituese dhe bashkëpunuar sidomos në dy vitet e fundit, në kryerjen e

---

<sup>4</sup> Marrëveshjet e Bashkëpunimit datë 23 prill 2012 mes KLSH dhe organizatës Transparency Internacional në Shqipëri, lëvizjes "Alternativa Civile", Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë, Institutit të Studimeve Bashkëkohore, Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Lëvizjes Evropiane, Shqipëri.

auditimeve paralele dhe të përbashkëta të performancës me SAI evropiane të zhvilluara dhe me SAI-t e rajonit.

Gjatë periudhës 2012-2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka nënshkruar 14 marrëveshje bashkëpunimi me SAI-t homologe të : Austrisë, Polonisë, Turqisë, Kroacisë, Sllovenisë, Kosovës, Bullgarisë, Çekisë, Malit të Zi, Bosnje Hercegovinës, Maqedonisë, Kuvajtit, Hungarisë dhe Qipros. Këto marrëveshje nuk kanë mbetur thjesht në letër, por kanë ngritur një partneritet konkret në fusha të tilla si shkëmbimi i informacionit, trajnime, veprimtari të përbashkëta audituese rajonale, etj. Në komunikimin dhe marrëdhëniet me SAI-et homologe, KLSH ka arritur një sukses në plotësimin e hartës rajonale, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me pothuajse të gjitha SAI-et e vendeve të rajonit. Një nga marrëveshjet e para të nënshkruara ka qenë ajo me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës.



*Gjatë nënshkrimit të Deklaratës së Përbashkët mes KLSH-së, përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj dhe Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë z. Krystof Kwiatowski.*



*Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes KLSH – së, përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj dhe Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Bullgarisë z. Tzvetan Tzvetkov*



*Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes KLSH-së, përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj dhe Presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Çekisë z. Miloslav Kala*



*Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes KLSH-së, përfaqësuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës përfaqësuar nga Auditori i Përgjithshëm z. Besnik Osmani*

Në modernizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë dhënë një kontribut të çmuar Gjykata Europiane e Audituesve (ECA), nëpërmjet intership-eve dhe Zyra e Auditimit të Qeverisë të SHBA-së (GAO), përmes fellow ship-eve, programe në të cilat audituesit e KLSH-së kanë marrë pjesë për herë të parë. Falë kësaj asistence, në KLSH po krijohet një gjeneratë e re audituesish me parametrat e kolegëve të tyre europianë. Audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë bërë pjesë e strukturave të ECA-s për një periudhë 5 mujore, duke përfutur nga programet e internshiptit të këtij institucioni, për të kontribuar pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA-s. Internshipi është konsideruar një mjet shumë i rëndësishëm për të ofruar njohuri mbi auditimin e fondeve të BE-së, për audituesit e SAI-ve të vendeve që aspirojnë të bëhen anëtare të BE-së. Në total janë 9 auditues të KLSH-së që kanë fituar internship-et tek ECA.

Po aq produktive për KLSH-në ka rezultuar edhe bashkëpunimi me GAO-n e SHBA-së. Ky program studimor 4-mujor është hartuar për të forcuar kapacitetet e SIA-ve për të rritur llogaridhënien dhe mirëqeverisjen. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të njihen me përvojën amerikane të auditimit, me qëllim zhvillimin e strategjive për të sjellë ndryshim dhe për ta përcjellë dijen e përfutur në SAI-et e vendeve të tyre respektive.

### 3.5. Delegacioni i BE-së në Shqipëri dhe SIGMA

Bashkimi Europian dhe Programi SIGMA janë partnerë shumë të rëndësishëm të KLSH. DG-Budget ka dhënë kontribut të vyer për miratimin e ligjit të ri të KLSH-së nga Kuvendi i Shqipërisë. Delegacioni i BE-së në Shqipëri ka dhënë kontribut dhe mbështetur projektin IPA 2013 të KLSH-së, *“Mbi forcimin e kapaciteteve të auditimit të Jashtëm në Shqipëri”*, i cili po implementohet aktualisht në KLSH në bashkëpunim me SAI-n polak(NIK) dhe atë kroat.

SIGMA është një nga partnerët kryesorë dhe ndër më të rëndësishmit e KLSH, jo vetëm për kontributin e tij në monitorimin dhe vlerësimin e përvitshëm të aktivitetit të KLSH, por edhe për ndihmësen thelbësore që ka dhënë gjatë procesit të miratimit të Ligjit të ri organik të institucionit në vitin 2014, si dhe realizimit të trajnimeve cilësore në fushën e auditimit të performancës, të auditimit financiar, të përputhshmërisë dhe të teknologjisë së informacionit. KLSH do të vazhdojë bashkëpunimin intensiv me SIGMA përgjatë periudhës 2017-2019 dhe më tej. SIGMA është padyshim një garanci e zhvillimit cilësor të kapaciteteve audituese të institucionit dhe të rritjes së transparencës së tij.

Bashkëpunimi me SIGMA-n ka qenë tepër produktiv në forcimin e komunikimit të KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë dhe me qytetarët. Programi SIGMA i ka përcjellë Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentin final mbi *“Zhvillimin e Marrëdhënieve Efektive mes SAI-ve dhe Parlamenteve”*, hartuar nga feedback-et e marra nga SAI-et europiane nga aktivitetet e organizuar nga SIGMA për këtë temë. Dokumenti përcjell mesazhin qendror se Institucionet Supreme të Auditimit(SAI-et) janë agjentë të Parlamentit, në funksion të monitorimit se si ekzekutivi i shpenzon fondet publike. Në trajtimin e praktikave më të mira europiane, dokumenti thekson se Parlamenti ka një rol të rëndësishëm për ndjekjen e rekomandimeve, zbatimin e të cilave përbën stimuj për menaxhimin e shëndoshë të financave publike. Një kapitull të veçantë i këtij dokumenti i kushtohet edhe marrëdhënies mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Kuvendit të Shqipërisë, ku vlerësohen marrëdhëniet e ngritura vitet e fundit mes KLSH-së dhe Kuvendit. Miratimi i ligjit organik 154/2014 të KLSH-së nga Kuvend që inkorporoi standardet e INTOSAI-t në auditimin e jashtëm në Shqipëri dhe që përforcoi pavarësinë e institucionit, konsiderohet se ka shënuar një nivel të ri në marrëdhëniet mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Në promovimin në opinionin publik të rolit të veçantë që ka Kontrolli i Lartë i Shtetit në luftën kundër korrupsionit në datat 14-15 qershor 2017, në Tiranë, u

organizua në bashkëpunim me SIGMA-n tryeza e rrumbullakët mbi "*Rolin e SAI-ve në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit*", ku mori pjesë Rrjeti i SAI-ve të vendeve candidate dhe potenciale candidate për anëtarësim në BE dhe të Gjykatës Evropiane të Audituesve.

Në këtë aktivitet ndërkombëtar merrnin pjesë përfaqësues nga Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) të Suedisë dhe Çekisë, nga SAI-t e rajonit të Kosovës, Bosnje-Hercegovinës, Turqisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Tryeza përcolli mesazhin e rëndësishëm se Institucionet Supreme të Auditimit janë një ndër veprimtarët kryesorë në luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit. Me mbikëqyrjen e financave publike dhe rolin e tyre në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik, ata japin një kontribut të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për mirëqeverisjen. Megjithatë, SAI-t kanë mandate të ndryshme në luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit dhe përballesh me sfida domethënëse në përmbushjen e pritshmërive të palëve të interesuara, kur është fjala për parandalimin, zbulimin dhe raportimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

### **3.6. Shoqatat kombëtare të profesionistëve të fushës dhe universitetet publike**

Shoqatat profesionale të fushës vlerësohen nga KLSH si një partner i rëndësishëm, veçanërisht Instituti i Eksperteve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) si dhe shoqatat e ndryshme të kontabilistëve. KLSH ka lidhur me këto shoqata marrëveshje bashkëpunimi dhe ka zhvilluar veprimtari me interes të ndërsjellë. Vlen të përmenden katër Konferencat Shkencore të KLSH, në të cilat ekspertë dhe drejtues të shoqatave profesionale kanë mbajtur kumtesa të rëndësishme, por edhe aktivitete të përbashkëta, si mini peer review, të cilat janë realizuar për herë të parë në institucion nga Organizata të shoqërisë civile.



KLSH ka institucionalizuar bashkëpunimin me institucionet akademike, sidomos me universitetet publike në Shqipëri, si Universitetin e Vlorës, Elbasanit, Shkodrës dhe, natyrisht me Universitetin e Tiranës dhe veçanërisht me Fakultetin Ekonomik. KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me Fakultetin e Gjeologji Minerave, e cila ka qenë shumë dobiprurëse për të dy institucionet.



*Gjatë leksionit me temë “Burimet, menaxhimi dhe stafi” mbajtur nga Prof. Dr. Skënder Osmani dhe Kryetari i KLSH-së, Dr. Bujar Leskaj*

KLSH e ka zgjeruar bashkëpunimin edhe me shoqatat profesionale të Republikës së Kosovës<sup>5</sup>, ku mund të përmendim marrëveshjen e bashkëpunimit me Institutin për Certifikimin e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës.

---


<sup>5</sup> *Statusi i përcaktuar sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB*

## 4. Botimet, Revista Shkencore dhe Java e Hapur, si mjete komunikimi dhe llogaridhënie

### 4.1 Botimet

Një shoqëri demokratike nuk kërkon thjesht një marrëdhënie individ-libër, por kërkon kalimin në një instancë më të lartë, mes institucionit dhe librit. Në kushtet e Shqipërisë, ku korrupsioni përbën një nga sfidat më të mëdha për vendin, lidhja e institucioneve me librin është pjesë integrale e luftës kundër korrupsionit. Dukshëm, binomi mirëqeverisje-kulturë është i pandashëm dhe për të ruajtur këtë ligjësi lypset afrimi i institucioneve shtetërore me librin, këtë “institucion” kulturor.

**Numri i botimeve, fokusi drejt së ardhmes**



KLSH vjen në pesë vitet e fundit 2012-2016 me një kolanë botimesh prej 67 titujsh. Çdo vit dinamika e botimeve të institucionit rritet me 10 përqind dhe përçojnë drejtimit strategjike të reformimit të institucionit, që janë rritja e kontributit në përmirësimin e qeverisjes publike. Botimet e KLSH-së janë zbatim i detyrimeve ndërkombëtare të angazhimit të institucioneve të auditimit edhe në fushën e botimeve të dokumentacionit për t’i mundësuar qytetarëve një akses më të gjerë. Kolana e botimeve, e cila pasurohet nga viti në vit, pasqyron çdo kronikë të reformave që ka nisur KLSH për të modernizuar institucionin drejt parametrave të SAI-ve europiane. Nëpërmjet tyre, ne rrisim transparencën

dhe llogaridhënien tonë si institucion pasi besimi i qytetarëve është burimi i pavarësisë sonë si institucion kushtetues.



KLSH do të vijojë të pasurojë kolanën e botimeve të tij edhe për vitin 2017, gjatë të cilit janë parashikuar të botohen 16 tituj (aktualisht janë botuar tetë prej tyre).



### Revista Shkencore “Auditim i Jashtëm Publik”

Duke filluar nga viti 2012, KLSH boton për herë të parë një Revistë kërkimore-shkencore. Revista “Auditimi Publik”, e botuar çdo katër muaj, e ideuar dhe e

iniciuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk përbën thjesht një botim, por përfaqëson një reformë institucionale në funksion të modernizimit të KLSH-së. Revista ka një bord shkencor me akademikë dhe profesorë të shquar, shqiptarë e të huaj, të fushës së ekonomisë, jurisprudencës dhe inxhinierisë.

Prezenca e figurave të njohura dhe me kontribute të botës akademike, komunitetit të INTOSAI-t, shoqërisë civile, institucioneve të tjera shtetërore flet për reformat që janë ndërmarrë për të shndërruar KLSH-në edhe në një institucion ku ka debat të mendimit shkencor, me profesionistë të fushës nga vendi dhe bota. Po ashtu, tematikat që trajtohen flasin për një evolucion të institucionit drejt auditimeve të performancës, mjedisit, të IT-së dhe të zhvillimit të metodologjisë audituese.

Rritja në numër e kësaj reviste (janë botuar 16 numra), kërkimore-shkencore, është një indikator i rritjes së kapaciteteve audituese të vetë KLSH-së dhe reflekton punimet shkencore të stafit të KLSH-së, botës akademike si dhe praktikave më të mira nga SAI-et Europiane.



Revista ka tre dimensione : Kërkimore, Shkencore dhe Informative dhe mund të aksesohet lehtësisht në faqen elektronike të KLSH-së. Revista e KLSH-së, duke filluar nga numri 5 i saj (viti 2013) është njohur nga Ministria e Arsimit

dhe e Shkencës si “Revistë Shkencore” dhe nga po ky numër është pajisur edhe me kodin e standardizuar ndërkombëtar që lejon identifikimin e çdo botimi në seri, ISSN( International Standard Serial Number). Përmes saj, Kontrolli i Lartë i Shtetit informon, në shqip dhe anglisht, opinionin publik dhe atë ndërkombëtar, mbi aktivitetet e çdo katër-mujori të KLSH-së. Përmes kësaj reviste, të gjithë palët e interesit mund të informohen mbi risitë në metodologjinë audituese, zhvillimet institucionale, marrëdhëniet me SAI-t homologe dhe mbi çdo aktivitet tjetër të KLSH-së. Revista ndjek një linjë editoriale të hapur, duke ruajtur natyrën e saj shkencore, dhe fton të publikojnë punimet dhe opinionet e tyre kontabilistë, financiarë, ekonomistë të përgjithshëm, specialistë të enteve publike dhe private, akademikë, ekspertë të shoqërisë civile, profesionistë të pavarur si dhe çdo i interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes në auditim dhe vlerësimin e administrimit publik të vendit, bazuar në moton e INTOSAI “*Experientia mutua omnibus prodest*” (Nga eksperiencia e Përbashkët përfitojnë të gjithë)”.

### **4.3. Java e Hapur për Qytetarët**

Mbështetur në standardin ndërkombëtar të institucioneve supreme të auditimit, ISSAI 12, “*Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit- të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve*”, parimi 6 “Komunikimi efektiv me palët e interesit”, dhe me qëllim njohjen më të plotë dhe të drejtpërdrejtë të veprimtarisë së Institucionit nga qytetarët, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka organizuar për herë të parë (gjatë viteve të fundit) Javën e Hapur për Qytetarët.

***Duke filluar nga viti 2017, KLSH çdo nëntor, do të organizojë muajin e hapur për qytetarët.***

Duke vlerësuar misionin e tij si agjent i publikut dhe i Kuvendit, për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të burimeve dhe fondeve publike, KLSH synon forcimin e besimit të qytetarit dhe publikut në tërësi, nëpërmjet njohjes më nga afër të veprimtarisë së tij, auditimeve dhe rezultateve të auditimit, si dhe partneritetet që ka krijuar brenda dhe jashtë vendit për të përmirësuar qeverisjen publike, duke u përpjekur të luftojë në thellësi korrupsionin.

Gjatë kësaj jave, qytetarët kanë pasur mundësinë të vizitojnë mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe mund të njihen me historikun dhe arritjet e

institucionit në 92 vitet e ekzistencës së tij nëpërmjet mini-muzeut të KLSH, të takohen me punonjës, auditues dhe ekspertë të ndryshëm të institucionit, për të marrë të gjithë informacionin që ata të dëshirojnë të kenë, përfshirë edhe auditimet në proces.

## **5. Risqet e komunikimit dhe menaxhimi i tyre**

### **5.1. Risqet**

Gjatë transmetimit të mesazhit nga institucioni ka gjithnjë risqe të cilat mund të “devijojnë” përmbajtjen e mesazhit tek grupet e interesit, si psh:

- Gjuha teknike dhe institucionale, që vështirëson kuptimin e mesazheve nga qytetarët;
- Perceptim jo i plotë dhe nga të gjithë audituesit dhe nëpunësit mbështetës, i vizionit dhe strategjisë institucionale, nën frymën e kuadrit të ri rregullator dhe të komunikimit gjithëpërfshirës me palët e interesit;
- Komunikim i izoluar i drejtorive të auditimit lidhur me mesazhet e përbashkëta që duhet të përcjellin në publik;
- Mungesë e një koordinatori të komunikimit në nivel departamenti auditimi;
- Risk në rritje për shkak të numrit të lartë të auditimeve dhe zgjerimit të spektrit të tyre bazuar në ligjin e ri të KLSH-së, që mund të kufizojnë kohën dhe burimet njerëzore për përgatitjen e mesazhit për publikun;
- Auditime në çështje komplekse, që mund të sjellin një mesazh konfuz për publikun;
- Burime buxhetore të kufizuara për shtrirjen e mesazhit në publik;
- Mungesë e kuptimit të plotë të rolit dhe mesazheve të Strategjisë së Komunikimit nga një pjesë e audituesve që do të jenë zbatues të saj.

### **5.2. Menaxhimi i risqeve**

- Drejtim efektiv i audituesve me përvojë në nxitjen dhe përgatitjen e audituesve të rinj për “daljen në publik”, për të thjeshtëzuar gjuhën teknike të auditimeve;
- Shtim i botimeve profesionale dhe shkencore në lëmin e auditimit dhe në fusha të tjera;
- Prani e rritur në mediat elektronike dhe në ato të shkruara, duke rritur impaktin e auditimeve;
- Promovim i daljes në publik nëpërmjet botimit të përmbledhjeve të shkrimeve të botuara të audituesve për çdo gjashtë muaj;

- Faktorë motivues në vendin e punës dhe avancimi në karrierë në funksion të përcjelljes së një mesazhi cilësor dhe të vazhdueshëm në publik;
- Forcimi i marrëdhënieve dhe rritja e impaktit përmes bashkëpunimit të ngushtë ndër-institucional;
- Inkurajim i institucioneve homologe, organizatave, shoqatave të ndryshme dhe njësive akademike për aktivitete të përbashkëta trajnimi dhe shkëmbimi eksperience;
- Inkurajim dhe instalim i bashkëpunimit të frytshëm me INTOSAI, EUROSAI dhe SAI-ve homologe të rajonit dhe më gjerë për sigurimin e mbështetjes në transformimin e praktikave të auditimit të performancës sipas standardeve ISSAI dhe praktikave më të mira të SAI-ve homologe, të hapura në komunikimin me publikun dhe qytetarin.
- Inkurajim i pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës ose organizatave joqeveritare në probleme specifike auditimi.



## **6. Objektivat strategjikë dhe Plan veprimi**

Objektivat strategjikë të KLSH janë përcaktuar në bazë të nevojave, kërkesave dhe sfidave të institucionit në komunikimin me publikun dhe palët e tjera të interesit, por edhe në bazë të burimeve aktuale njerëzore dhe financiare dhe mundësisë së kufizuar të rritjes së tyre për periudhën e realizimit të Strategjisë:

**Objektivi Nr. 1:** Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni.

**Objektivi Nr. 2:** Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut.

**Objektivi Nr. 3:** Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinioni publik rezultatet dhe dobitë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit.

**Objektivi Nr. 4:** Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rumbullakëta.

**Objektivi Nr. 5:** Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive.

**Objektivi Nr. 6:** Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit.

## **Objektivi Nr. 1: Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni**

Gjatë viteve 2012- 2017, perceptimi i qytetarit dhe i opinionit publik për KLSH, ideja që ai ka krijuar për këtë institucion kushtetues ka ndryshuar në themel. Përshtypja, imazhi që qytetari ka krijuar në këto pesë vite e gjysëm të ndryshimeve të mëdha në institucion është ai i një institucioni auditimi:

- Të depolitizuar dhe të pavarur;
- Të hapur për mediat dhe qytetarin;
- Që lufton pa kompromis korrupsionin;
- Që denoncon afëra të dyshimta dhe shkelje të rënda të disiplinës financiare të Shtetit dhe të interesit të taksapaguesit;
- Që respekton me rigorozitet standardet ndërkombëtare të auditimit;
- Që zhvillon një partneritet të hapur dhe shumë dobiprurës për institucionin, me institucionet simotra evropiane të zhvilluara dhe me Bashkimin Evropian.

Megjithëse imazhi dhe profili në publik i KLSH ka evoluar, është rritur dhe fuqizuar në sytë e qytetarit përgjatë viteve 2012-2017, ende ai nuk është në përmasat e tij të plota. Ndërsa ka dalë i plotë dimensionin e KLSH-së si një institucion i pavarur nga politika dhe strukturat qeveritare dimensionin tjetër i një institucioni që lufton fort korrupsionin dhe mashtrimin financiar është po ashtu i plotë.

Dimensioni po aq i rëndësishëm i këshillimit të një SAI, i rolit të tij parandalues dhe këshillues është ende pak i njohur tek qytetari. Ndonëse institucioni ka themeluar që në tetor 2012 Departamentin e Auditimit të Performancës me auditues të përgatitur dhe me eksperiencë, si dhe me auditues të rinj me perspektivë, ndonëse auditimet e performancës kanë njohur një rritje të konsiderueshme në numër, cilësi dhe mbulim temash dhe fushash auditimi, ende impakti i tyre tek qytetari, gjenerimi i një diskutimi publik për gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve të performancës është i kufizuar. Ky është një problem që e hasin edhe SAI-t e zhvilluara të BE-së dhe tek ne theksohet edhe më shumë nga mungesa e kulturës së debatit qytetar për problemet e përditshme.

Strategjia e Komunikimit të KLSH 2017-2019 do ta trajtojë këtë pamjaftueshmëri, me masa që synojnë të rrisin impaktin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimeve në publik. Mesazhi i një auditimi duhet të shkojë deri tek qytetari i thjeshtë dhe rrugët për ta aksesuar atë janë tashmë të shumta, që nga mediat tradicionale e deri tek mediat sociale, blogjet dhe dëgjuesat publike.

Po ashtu, propozimet kryesore të KLSH në përmirësimin e administrimit të Buxhetit të Shtetit, të tilla si kufiri tavan i borxhit publik, ligji për përgjegjësinë materiale të nëpunësit publik, etj., si dhe në tërësi, të financave publike, do të gjejnë më shumë jehonë dhe qasje në mediat si tradicionale edhe sociale.

Plani i Veprimit të Strategjisë do të përmbajë:

- Prodhimin dhe shpërndarjen e fletë-palosjeve, broshurave me mesazhet kryesore të auditimeve dhe të propozimeve të KLSH për përmirësimin e administrimit të Buxhetit të Shtetit;
- Përcjelljen më fort dhe qartë të mesazheve kryesore të auditimeve të performancës dhe të propozimeve të KLSH për përmirësimin e administrimit të Buxhetit të Shtetit në mediat tradicionale, në gazetatat dhe revistat kryesore, nëpërmjet shkrimeve të audituesve të KLSH, si dhe kontributeve nga analistë dhe gazetarë të njohur, partnerë të KLSH;
- Afrimin më shumë të audituesve të talentuar për shkrime dhe të vetë gazetarëve dhe analistëve pranë departamenteve të auditimit, për kuptimin prej tyre të mesazheve qendrore të auditimeve dhe përcjelljen e tyre në publik nëpërmjet një gjuhe të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë për qytetarin;
- Realizimin e emisioneve televizive dhe radiofonike me drejtues dhe auditues me eksperiencë, por edhe specialistë të KLSH në fushën e menaxhimit të financave publike;
- Organizimi i Ditës së Performancës Publike të Shtetit Shqiptar, për të dhënë fort mesazhet kryesore të KLSH, sidomos në fushën e këshillimit.

## **Objektivi Nr. 2: Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut**

Me zhvillimin e teknologjisë së informacionit, mundësitë e një institucioni publik për të aksesuar qytetarin, për ta informuar atë dhe për ta bërë pjesëmarrës në dhënien e opinioneve për aktivitetin publik të institucionit bëhen gati të pafundme. Kjo përbën një sfidë dhe për qeverisjen tonë publike, në të cilën KLSH do të synojë të luajë rolin e vet promovues dhe nxitës, për rritjen e transparencës, besimit të qytetarit në qeverisje dhe kufizimin e korrupsionit.

Në datat 31 maj-02 qershor 2017, në Vjenë u mbajt Simpoziumi i 24-t i Përbashkët OKB-INTOSAI, me temë: *”Dixhitalizimi, të dhënat e hapura dhe miniera e të dhënave: rëndësia dhe implikimet për punën audituese të SAI-ve dhe për rritjen e kontributeve të tyre në ndjekjen dhe vlerësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”*. Të dhënat e hapura (open data), qasja e pakufizuar elektronike në informacion, janë quajtur "vaji i ri" që lubrifikon shoqëritë moderne. Ato kanë implikime shumë të gjera për të gjitha agjencitë publike, duke përfshirë institucionet supreme të auditimit (SAI-t), pasi kërkojnë prej tyre që të ndryshojnë në mënyrë drastike mënyrën se si e organizojnë punën e tyre dhe qasjen ndaj publikut dhe qytetarit.

Jo vetëm Simpoziumi OKB-INTOSAI, por edhe pak muaj më parë Kongresi INCOSAI XXII dhe Kongresi i X-të i EUROSAT-t, dhanë orientime të qarta që SAI-t të zhvillojnë, në përputhje me kapacitetet e tyre, strategjitë dhe taktikat e tyre të brendshme në fushën e dixhitalizimit, të krijimit dhe ndërtimit të *data base* të të dhënave të hapura, në mënyrë që të ndërtojnë burimet e duhura njerëzore edhe në fushën e marrëdhënieve me publikun.

Strategjia e Komunikimit të KLSH 2017-2019 do të përballet me këtë sfidë, nisur nga përvoja pozitive e deritanishme e Departamentit të Performancës, i cili ka disa vite që ka hapur një faqe në rrjetin social “Facebook”. Strategjia do të synojë që kjo faqe të bëhet akoma dhe më interaktive me qytetarin, duke parashikuar rubrika për marjen e drejtpërdrejtë të mendimit të tij për gjetjet dhe rekomandimet nga auditimet e Departamentit, ose nga aktivitetet e tij dhe temat e shtruara për debat prej tij.

Drejtoria e Komunikimit do të bëhet lider në qasjen e re të KLSH ndaj mediave sociale, duke ndihmuar departamentet e auditimit të hapin faqet e tyre në Facebook, Instagram, LinkedIn apo Twitter, ndërkohë që Njësia e IT në institucion mund të trajtojë koordinorët e marrëdhënieve me publikun dhe qytetarin pranë çdo departamenti auditimi, për hapjen dhe mbajtjen e faqes së departamentit të tyre në rrjetet sociale, duke pasur si referencë pozitive eksperiencën e Departamentit të Auditimit të Performancës në këtë drejtim. Gjithsecili në KLSH duhet të jetë i vetëdijshëm se prapa “daljes në publik” dhe marrëdhënies më të ngushtë me qytetarin qëndron një punë profesionale, e cila nuk mund të realizohet nga një ose dy persona, por duhet bërë pjesë e natyrshme e përshkrimit të punës dhe detyrave të secilit departament auditimi. Departamenti i Performancës e ka nisur tashmë këtë rrugë dhe përvoja e tij forcon besimin tek drejtuesit dhe audituesit e departamenteve të tjera se kjo është rruga e vetme për të qenë profesionistë dhe të pranishëm në debatin publik, nëpërmjet rrjeteve sociale.

Plani i Veprimit të Strategjisë për këtë Objektiv të dytë strategjik, do të përmbajë :

1. Caktimin e një koordinatori për marrëdhëniet me publikun dhe qytetarin pranë çdo departamenti auditimi;
2. Hapjen dhe mirëmbajtjen e një faqeje në rrjetet sociale (Facebook, Instagram, Twitter, etj.) për çdo departament auditimi;
3. Ristrukturimin dhe përditësimin e Portalit të KLSH [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al), duke vendosur dritare të reja të komunikimit interaktiv dhe të drejtpërdrejtë me qytetarin, të tipit “Shërbimet publike dhe TI (qytetari)”, “Qeverisja vendore dhe TI”, etj.
4. Publikimin elektronik të buletinit tre mujor “Të bashkuar kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit” në shqip dhe anglisht, në bashkëpunim me përfaqësues të shoqërisë civile, etj.

### **Objektivi Nr. 3: Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinioni publik rezultatet dhe dobisë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit**

Deri tani, garantimi i cilësisë së mesazhit në publik të përgatitur nga specialistë të Drejtorisë së Komunikimit, Publikimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë të KLSH, nga drejtues të KLSH ose auditues, është përballuar pothuajse tërësisht nga Kryetari i KLSH. Kjo ka ndikuar në shmangien e gabimeve tematike ose në përmbajtje të mesazhit të dhënë, si dhe në përcjelljen e një mesazhi sa më konçiz dhe profesional.

Sfida e kohës kërkon që mesazhi i një SAI të jetë i qartë, i thjeshtë, i kuptueshëm, tërheqës dhe i goditur. Për këtë, institucioni duhet të mbështetet tek një grup ekspertësh të jashtëm, specialistë të fushës së marrëdhënieve me publikun dhe publicistikës, të aftë të ndihmojnë KLSH-në në mënyrë që prurjet e tyre të kontribuojnë në diversifikimin dhe dendësimin e përcjelljes së tij në mediat tradicionale dhe rrjetet sociale.

Plani i Veprimit të Strategjisë për këtë Objektiv të tretë strategjik, do të përmbajë:

1. Caktimin e një grupi drejtuesish të KLSH si “përcjellës të autorizuar” të mesazhit të institucionit në publik, të aftë dhe të mandatuar të përfaqësojnë institucionin në emisione televizive apo radiofonike ku diskutohen tema kyçe të shërbimeve publike, menaxhimit financiar publik, qeverisjes vendore, etj. Si edhe përcaktimi i koordinatorit për marrëdhëniet me publikun dhe qytetarin pranë çdo departamenti auditimi;
2. Hapjen e blogjeve tematike, të menaxhuara nga një anëtar i Grupit të mësipërm, nga auditues me përvojë dhe nga koordinatori i departamentit përkatës të auditimit;
3. Dhënien e kontributit të gazetarëve dhe analistëve të njohur, partnerë të KLSH për tema të caktuara ose “kryemesazhe” të institucionit (si p.sh. ligji për përgjegjësinë materiale të nëpunësit publik, etj.), në formën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në përgatitjen e mesazhit ose ndihmesës nga jashtë, me anë të opinionëve, editorialeve, prononcimeve në emisione të mediave vizive, pjesëmarrjes në blogjet tematike, etj.

#### **Objektivi Nr. 4: Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rumbullakëta**

Simpoziumi i 24-t i Përbashkët OKB-INTOSA i maj-qershorit 2017 theksoi sfidën e përdorimit të të dhënave të hapura (“open data”) jo vetëm si inpute për auditimet, por edhe si outpute në përdorim të qytetarit, duke cilësuar se *“të dhënat nga auditimi mund të publikohen si të dhëna të hapura, me qëllim që të merret përfitim shtesë për publikun... Për këtë, SAI-t kanë një rol qendror në promovimin e transparencës, si dhe aksesit të qytetarit, publikut dhe shoqërisë civile në informacionin qeveritar”<sup>6</sup>*.

Me qeverisjen elektronike, qeveritë mund të bëhen më transparente në sytë e qytetarit, pasi mund ta vendosin informacionin menjëherë në dispozicion të tij në kohë reale dhe ta bëjnë lehtësisht të arritshëm për të. Në të njëjtën kohë, qytetarët gjithnjë e më shumë po përfshihen në çështjet e auditimit. Ata mund të bëhen pjesëmarrës në auditimet e KLSH-së, duke ofruar indicie apo opinione për një sërë çështjesh apo fushash problematike, apo edhe të veprojnë si auditues në lidhje me programe ose shërbime publike. Estonia është një vend pionier në e-qeverisjen dhe në përfshirjen elektronike (me anë të programeve kompjuterike) të qytetarëve në auditimet e SAI-t estonez.

Shembulli i SAI-t estonez mund të fillojë të praktikohet edhe tek ne, në formën e një dritareje interaktive pilot “Ftesë në auditim” në portalin e KLSH-së ose në portalin “Auditimi publik dhe qytetari”. Marrja “online” e mendimeve të qytetarëve për auditimet që do të kryhen së afërmi, ose për auditime tashmë të filluara, konsultimi i tyre në faza të ndryshme të një auditimi janë rrugë shumë efektive për të rritur pjesëmarrjen e qytetarit (demokracia pjesëmarrëse) në procesin auditues, por edhe besueshmërinë dhe imazhin e institucionit në publik.

Auditime të caktuara, nëse ky konsultim ka funksionuar, mund të ketë një aneks me titull “Mendimet dhe vlerësimet e qytetarëve për dobishmërinë dhe mënyrën e realizimit të auditimit”.

---

<sup>6</sup> Raport mbi Simpoziumin e 24-t OKB-INTOSAI, faqe 3-4  
[http://asosai.org/asosai/news/whats\\_new\\_detail.jsp?id=11010](http://asosai.org/asosai/news/whats_new_detail.jsp?id=11010)

## **Objektivi Nr. 5: Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive**

Deri tani, kontributi i audituesve dhe drejtuesve të KLSH në median e shkruar 2013-2017 ka qenë një ide dhe nismë personale e Kryetarit të KLSH, e cila është kthyer tashmë pjesë e punës së audituesve të KLSH-së.

Në mënyrë që ky kontribut të bëhet më mirë i menaxhueshëm dhe i strukturuar në kohë, pa dëmtuar nismën personale dhe kredon e integritetin e askujt nga audituesit që parapëlqejnë të kontribuojnë, koordinatorët e marrëdhënieve me publikun dhe qytetarin pranë secilit departament auditimi do të kenë detyrën e raportimit një herë në çdo dy muaj për prurjet në median e shkruar të audituesve të departamentit, si dhe një plan(aty ku është e mundur) për temat që audituesit e departamentit mendojnë të trajtojnë në periudhën e ardhshme dy-mujore. Koordinatorët do të përgatisin një raport gjashtë mujor edhe më të detajuar rreth tematikave të trajtuara dhe kontributit të secilit auditues të departamentit në median e shkruar dhe për ta do të organizohen trajnime lidhur me mënyrën e përcjelljes së rezultateve të auditimit në media.

Është i rëndësishëm të theksohet fakti që mbi 70 përqind e qytetarëve marrin informacion kryesisht ose vetëm nëpërmjet televizionit.

Krahas realizimit të Pikës 1 të Objektivit të Tretë strategjik për caktimin e një grupi drejtuesish të KLSH si “përcjellës të autorizuar të mesazhit të institucionit në publik”, sa herë ka ftesa nga emisione televizive për kontributin e ekspertizës së institucionit, duhet të mendohet për një bashkëpunim të qëndrueshëm njëvjeçar për vitin 2018, me një televizion kombëtar ose shumë të shikuar, për bashkë-organizimin e një emisioni mujor Televiziv “Auditimi publik, qeverisja dhe qytetari” ose përfshirja në një emision ekzistues që trajton tema të fushës së ekonomisë. KLSH do të tregojë kujdesin e duhur për të ruajtur raportet e duhura me subjektet e audituara (ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, etj).



## **Objektivi Nr. 6: Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit**

KLSH ka intranet të zhvilluar. Çdo auditues ka akses në të dhe ai është përdorur kryesisht për përcjelljen e informacioneve mbi auditimet, por komunikimi mes audituesve nga departamente të ndryshme, përdorimi i tij si një platformë për shkëmbim mendimesh dhe opinionesh, ka munguar.

Strategjia e Komunikimit 2017-2019 parashikon një rol aktiv të koordinatorëve të marrëdhënive me publikun dhe qytetarin të Departamenteve të Auditimit në intranet. Në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit, Koordinatori do të hedhë për diskutim përmes intranetit, tema auditimi ku auditues të ndryshëm kanë mendime dhe qasje të ndryshme. Intraneti mund të përdoret prej tyre për marrje mendimesh nga auditues me përvojë lidhur me temat për t'u trajtuar në shtyp nëpërmjet shkrimeve të audituesve më të rinj, ose për mendime dhe kontribute në përgatitje të materialeve informuese nga ana e departamentit, sidomos në periudha përpara analizës vjetore apo në përgatitje të materialeve për konferencat shkencore, etj.

Çdo koordinator mund të përgatisë dhe ruajë në intranet, në këtë bibliotekë virtuale, bazën e të dhënave për materialet dhe mesazhet e përcjella në publik nga departamenti për një periudhë kohore (një vit, dy vjet, etj.). Kjo bazë të dhënash mund të jetë e dobishme si referencë për përgatitjen e materialeve të reja ose mesazheve të reja për publikun.

Gjithashtu intraneti do të shërbejë si një burim informacioni për çdo aktivitet të KLSH-së nëpërmjet kalendarit të eventeve. Kjo ndihmon audituesit të kenë informacion më të plotë. Në strategjinë e Komunikimit 2017 - 2018 parashikohet një zhvillim i intranetit në funksion të stafit të KLSH edhe kur ata janë jashtë institucionit, kjo realizohet nëpërmjet komunikimit intranet dhe e-mail, në mënyrë që informacionet të gjenerohen nga intraneti në adresat e e-mail-it.

Strategjia e Komunikimit 2017 - 2018 parashikon një mbështetje të fortë në përdorimin e internetit, mediave sociale duke përdorur shpesh, intensivisht dhe në mënyrë të përsëritur faqen e KLSH në internet, hapjen e një llogarie në

rrjetet sociale si facebook (veçmas për secilin departament), instagram, LinkedIn si dhe rrjete të tjera siç mund të jetë *youtube*.

Vlerësimet për përdoruesit e Facebook në Shqipëri arrijnë në një total prej 1.5 milion përdorues dhe një përqindje e madhe e përdoruesve të Facebook në Shqipëri janë të rinjtë, studentët dhe zyrtarët e administratës publike apo të sektorit privat. Kështu, përmes përdorimit të Facebook dhe mediave të tjera sociale, Strategjia synon të shpërndajë në një masë të madhe misionin, vizionin dhe gjetjet e KLSH dhe kryesisht tek të rinjtë, të cilët mund të konsolidojnë reagimin ndaj shpërdorimit të buxhetit.

### **Përdorimi i rrjeteve sociale**

- a) Hapja e një llogari në media-t sociale, ku përfshihet logo + slogan (mision, vizion i KLSH) dhe planifikimi nga Drejtoria e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë e postimeve për promovimin e faqes së KLSH në rrjetet sociale.
- b) Përmes rrjeteve sociale të njoftohet publiku për aktivitete të KLSH-së si dhe për publikimet e raporteve të auditimit për subjektet e audituara, të shoqëruara më një përshkrim të shkurtër.

Të gjitha postimet në rrjetet sociale duhet të jenë të shoqëruara me linke nga faqja zyrtare e KLSH, kjo ndihmon në promovimin e faqes zyrtare të institucionit dhe e bën lehtësisht të aksesueshme nga publiku.

## **7. Burimet**

Burimet në dispozicion të KLSH për realizimin e strategjisë janë burime të brendshme dhe të jashtme. Institucioni është i angazhuar për t'i përdorur këto burime me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet. Kapacitetet njerëzore të KLSH janë burimi kryesor. Drejtoria e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, pavarësisht numrit të kufizuar të stafit, ka fituar eksperiencë dhe ka detyrën funksionale të përmbushë realizimin e kësaj strategjie. Stafi zotëron një nivel të mirë ekspertize dhe ka kontaktet e duhura por ka gjithashtu bashkëpunimin e duhur me strukturat e tjera të KLSH-së. Ekspertët e jashtëm që institucioni angazhon në fushën e Komunikimit janë po ashtu një aset me vlerë në realizimin e Strategjisë.

Strategjia e Komunikimit 2017-2019 kërkon që të formulohen politika të përshtatshme për krijimin e një stafi kompetent, të aftë që të përballojë misionin dhe objektivat e strategjisë.

Politikat e zbatuara të rekrutimit që i japin përparësi rekrutimit të personelit në moshë relativisht të re dhe që ka kryer kualifikime shkencore është një burim tjetër potencial për realizimin e strategjisë.

Buxheti i Shtetit i ka alokuar burime financiare modeste KLSH për të kryer veprimtarinë e auditimit dhe atë të menaxhimit institucional (përfshirë publikimet, botimet, etj.). Megjithatë, fakti që këto burime përdoren në mënyre të pavarur është një tjetër siguri për të përmbushur kërkesat e Strategjisë. KLSH i nevojitet me përparësi rinovimi tërësor i inventarit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të realizuar në kohë reale objektivat e Strategjisë së Komunikimit.

## 8. Monitorimi i Strategjisë, kontrolli dhe raportimi

Plani strategjik është element vendimtar për zhvillimin e një strategjie të përshtatshme komunikimi për çdo SAI. Suksesi i strategjisë është i lidhur ngushtë edhe me monitorimin e vazhdueshëm të progresit të objektivave dhe masave, si dhe korrigjimin në kohë apo përcaktimin e objektivave dhe masave të reja.

Është shumë e rëndësishme të analizohet procesi i komunikimit, në mënyrë që të riparohen mangësitë dhe të arrihen më mirë objektivat strategjike në të ardhmen. “Mesazhi” i strategjisë së komunikimit të SAI-t duhet të evidentojë jo vetëm objektivat e veçanta të auditimit, por edhe objektivat e përgjithshme të institucionit. Kështu, gjatë monitorimit të strategjisë së komunikimit duhet të gjejnë përgjigje pyetjet e mëposhtme të përshkruara në hapat e piramidës së vendimmarrjes strategjike të SAI-t për komunikimin, duke përfshirë burimet për realizimin e strategjisë, aktivitetet, mesazhin/et, rezultatet që dëshirojnë të arrijnë dhe rezultatet e arritura (ndikimi në publik). Përfundimisht, dërgimi i mesazhit në publik duhet të jetë i tillë që të arrijë përcimin e mesazhit të duhur të SAI-t në publik.



*Piramida e vendimmarrjes strategjike të SAI-t*

Analiza e monitorimit të funksionimit të strategjisë së komunikimit sipas skemës së mësipërme do të ndihmojë KLSH-në për të kuptuar më mirë se si

është realizuar informimi i publikut për temat e një rëndësie strategjike, por edhe për auditime të veçanta, ashtu sikurse edhe për mesazhe të tjera që lidhen me aktivitetin e KLSH-së. Kjo analizë mund të përdoret gjithashtu për qëllime të komunikimit të brendshëm, në mënyrë që çdo punonjës të jetë më i vetëdijshëm rreth rezultateve përfundimtare të kontributit të tij në nivel institucional.

Drejtorja e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në KLSH përcaktohet si njësi përgjegjëse për ndjekjen dhe raportimin e progresit të kësaj strategjie. Strukturat përgjegjëse në institucion, të cilave u janë adresuar masa në Planin e Veprimit i paraqesin kësaj Drejtorie jo më vonë se 15 ditë nga mbarimi i gjashtëmujorit të çdo viti, një raport me shkrim lidhur me progresin e zbatimit të masave, si dhe një vlerësim për shkaqet e mos-realizimit të tyre dhe propozimet eventuale për ndryshimin e masave, objektivave apo afateve, kurdoherë të arsyetuara. Drejtorja e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, pas marrjes çdo gjashtë muaj të raporteve të zbatimit të Strategjisë nga strukturat përgjegjëse të ngarkuara, kryen verifikime të mëtejshme dhe konsultime dhe mbi bazën e një analize të plotë të progresit të zbatimit, bën propozime për ndryshimin e objektivave, masave dhe afateve të zbatimit dhe jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i gjashtëmujorit të çdo viti, ia paraqet Kryetarit të KLSH, i cili vendos në lidhje me këto propozime.

Raporti përfundimtar i rishikimit miratohet nga Kryetari i KLSH dhe i shpërndahet të gjithë stafit të KLSH.

*Shënim: Strategjia e Komunikimit të KLSH-së është produkt i bashkëpunimit me ekspertët e SAI-t polak në kuadër të projektit të Binjakëzimit, IPA 2013, ” Forcimi i Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm Publik” dhe konkretisht të Komponentit 3, “Forcimi i kapaciteteve institucionale të KLSH-së dhe përmirësimi i impaktit të rezultateve të auditimit” (misionet 3.2.1-3.2.7).*

*KLSH është mbështetur në arritjet dhe risitë e institucionit ne vitet 2012-2017, si dhe në urdhrat, udhëzimet e Kryetarit të KLSH-së për këtë çështje.*

*Strategjia e Komunikimit të KLSH-së ka pasur gjithashtu si referencë :*

- *Strategjinë e INTOSAI-t, 2017-2022*
- *Strategjinë e EUROSAI-t, 2017-2023*
- *“Rruga drejt përmbushjes së objektivave të komunikimit të SAI-t”, dokument i prodhuar nga Grupi i Punës së EUROSAI-t mbi Ndërtimin e Kapaciteteve.*